


REVISTA VJETORE

SINDIKATA E PUNONJESVE TE POSTE-TELEKOMIT SHQIPTAR



2018–2019



ADRESA: Bulevardi "Bajram Curri", Nr. 29 Tiranë, Albania.

EMAIL: info@sindikata.net

FACEBOOK PAGE: Sindikata e Punonjesve Poste-Telekomit Shqiptar SPPT
<https://www.facebook.com/sindikata.postetelekomitshqiptar.3>

INSTAGRAM: @sindikata1991

Cel: +355 67 68 33 333

www.sindikata.net

NË KËTË RRUGË TË VËSHTIRË NJË FALENDERIM
SHKON PËR TË GJITHË PARTNERËT TANË!



Kush jemi?

SPPTSH është një organizatë sindikale sektoriale në të cilën aderojnë kryesisht punonjësit e telekomunikacionit, shërbimeve postare dhe është e hapur për të gjithë individët, sektorët privat dhe publik që i përkasin këtyre fushave apo profesioneve të tjera, si dhe sindikata të profesioneve që dëshirojnë anëtarësimin në këtë Sindikatë.

Themeli i Sindikatës së bashkuar të PTT në të gjithë Shqipërinë u vendos në shkurt të vitit 1991, ku dy Sindikata ajo e Uzinës PTT dhe PTT Tirana mbajtën Kongresin e Parë. Nga ky kongres u zgjodhën edhe drejtuesit e parë të SPPTSH-së dhe kryetare u zgjodh znj. Rajmonda Paçuka, zv/kryetar. z. Shpëtim Vojka dhe sekretar z. Aleksandër Miraj. Që nga themelimi i saj, kjo sindikatë ka pasur si qëllim të bashkojë dhe të organizojë punonjësit, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, etnia, raca, profesiuni, gjinia apo bindjet fetare.

Në vazhdim Sindikata është drejtuar nga të zgjedhurit në Kongreset, që ajo ka organizuar. Më poshtë po listojmë kongreset dhe kryetarët e zgjedhur ndër vite:

- Kongresi II 1995 – znj. Rajmonda Paçuka
- Kongresi III 2001 - z. Aleksandër Miraj
- Kongresi IV 2005 – z. Shpëtim Vojka
- Kongresi V 2009 – z. Shpëtim Vojka
- Kongresi VI 2014 – z. Renato Muçaj
- Kongresi VII 2017 – z. Renato Muçaj

SPPTSH është një organizatë e ngritur nga aderimi mbi baza vullnetare të punonjësve, dhe ka si mision të mbrojë dhe promovojë interesat e anëtarëve të saj, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar të punës dhe të drejtat e njeriut. Sot, SPPTSH rregullon marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punonjësve të punësuar në Albtelecom, Makhes, Unit Center (Call Center) dhe Postës Shqiptare.

SPPTSH është e organizuar në të gjithë Shqipërinë me disa qendra rajonale. SPPTSH është anëtare në Federatën Ndërkombëtare të Sindikatave të shërbimit, UNI GLOBAL UNION, e cila është ndër më të mëdhatë dhe përfaqëson 20 milion punonjës, nga 900 sindikata në 140 vende të ndryshme.



KRYETARI I SINDIKATËS SË PUNONJËSVE TË POSTE-TELEKOMIT SHQIPTAR



Të nderuar motra dhe vellezër sindikaliste të SPPTSH-së,

Revista jonë, një raport vjetor ku përmblidhen aktivitetet kryesore të sindikatës eshtë një risi për organizatat sindikaliste në Shqipëri. Kjo risi filloj të aplikohet nga sindikata jonë për herë të parë në vitin 2016. Për këtë arsyje jam krenar që ky raport vjetor sot vjen për të gjithë anëtarët tanë në botimin e tij të katërt. Revista vjetore vjen në kuadër të transparencës dhe informimit që ne si organizatë punë-marrësish aplikojmë për të gjithë punonjësit anëtar ose jo të sindikatës. Pavarësisht se aktivitetet tona pasqyrohen në kohë reale si në rrjete sociale ashtu dhe në faqen tonë të web-it (www.sindikata.net) ky raport eshtë një mundësi e mirë informimi për të gjithë partnerët dhe bashkëpunorët tanë që duan të informohen në mënyrë të përbledhur mbi punën e sindikatës sonë.

Viti 2019 ishte një vit shumë i rëndësishëm dhe i sukseshëm për Sindikatën tonë pasi gjatë këtij viti u firmosën tre kontrata kolektive. Një nga qëllimet dhe detyrat kryesore të Sindikatës eshtë mbrojtja e të drejtave të punonjësve. Sigurisht që mekanizmi më i rëndësishëm ligjor që disponon sindikata eshtë kontrata kolektive e cila eshtë një garanci themelore për të gjithë punonjësit. Kontrata kolektive nuk eshtë vetëm forma ligjore që nënshkruhet midis punëdhënësit dhe sindikatës por eshtë dhe guri kilometrik për zhvillimin e mëtejshëm të dialogut social midis palëve në këtë process.

Me firmosjen e kontratave të reja me kompanitë Albtelecom, Makhes, dhe BTC (Best Training & Consulting) që operon në fushën e call centerit, SPPTSH, jo vetëm ka përbushur një nga detyrat e saj por ka siguruar standarde më të larta pune për të gjithë anëtarët e saj. Prandaj ky vit ka përfunduar si një vit historik ku për herë të parë në historinë e sindikalizmit shqiptar firmoset një kontratë kolektive në sektorin e call centerave duke e kthyer edhe këtë vend pune në një vend pune të denjë.

Si drejtues i SPPTSH-së, jam shumë i lumtur që po arrjmë të përbushim strategjinë e miratuar në Kongresin e VII-të të SPPTSH-së (10 Shkurt 2017), për një përfaqësim sa më sektorial të sindikatës sonë. Kur prezantuam strategjinë e re të sindikatës sonë shumë ishin skeptik në realizimin e kesaj strategji por vullneti dhe puna jonë e vazhdueshme bëri që kjo strategji jo vetëm të ishte e duhura por të implementohej më sukses.

Ndryshimet statutore të miratuara ne Kongresin e VII-të i mundësojnë sindikatës që tashmë mos të jetë e hapur vetëm për kompanitë e sektorit por të jetë e hapur për të gjithë individët, sektorët privat dhe publik që i përkasin këtyre fushave apo profesioneve të tjera, si dhe sindikata të profesioneve që dëshirojnë anëtarësimin në këtë Sindikatë.

Në kuadër të strategjisë, gjatë këtij viti përveç rritjes sektoriale i eshtë kushtuar shumë rëndësi organizimit të brendshëm, rritjes së kapaciteteve dhe shëndrimtit të sindikatës në një zë publik për të gjithë punonjësit e sektorit.



Ne 16 Tetor 2018, në bashkëpunim me fondacionin gjerman Friedrich Ebert, duke u bërë sindikata e parë që ndërrmer një iniciativë të tillë, organizuan konferencen e parë të Telekomunikacionit në Shqipëri, ku merrnin pjesë përfaqësues të Qeverisë, Parlamentit, AKEP, përfaqësues të Kompanive, punonjës si dhe përfaqësues ndërkombëtarë të fushës së telekomunikacionit. Kryefala e konferencës ishte e ardhmja e sektorit, sfidat dhe mbrotja e punonjësve nga këto ndryshime që pritet të pësojë sektori telekomunikacionit. Kjo konference pati një jehonë të madhe në media për vet faktin sepse doli me një rezolutë me kërkesa konkrete për të gjithë pjesëmarrësit.

Por edhe gjatë vitit 2019, sindikata janë ka tërhequr vëmendjen e mediave, duke ngritur shumë shqetësimë te punonjësve te telekomunikaciont dhe te atyre te call center.

Një numër i lart aktivitetesh sindikale janë zhvilluar gjatë vitit 2019 duke u fokusuar te organizimi i brendshem, rritia e kapaciteteve dhe forcimi i bashkepunimit si me partnere vendas dhe te huaj. Janë zhvilluar një seri trajnimesh për përfaqësuesit e zgjedhur të sindikatës dhe punonjësit tanë në të gjithë Shqipërinë. Këto trajnime të zhvilluara në bashkëpunim me fondacionin suedezi Olof Palme dhe atë gjerman Friedrich Ebert në kuadër të kontratës kolektive kanë pasur në fokus rrityen e kapaciteteve për të gjithë punonjësit dhe forcimin e sindikatës.

Por për të marr opinionin e tyre janë përdorur edhe takime një-me-një dhe anketime online. Të gjitha këto problematika të mbledhura i janë paraqitur drejtuesve të kompanive respektive. Në vazhdim të planit të miratuar nga Këshilli Kombëtar për të vitalizuar anëtarësinë e SPPTSH-së janë zhvilluar dhe shumë aktivitete social-kulturore.

Një rëndësi të veçantë për ne si sindikatë ka dhe bashkëpunimi me partnerët tanë kombëtar dhe ndërkombëtar i cili edhe këtë vit nuk ka munguar. Prandaj unë gjej rastin të falenderoj edhe njëherë, Fondacionin gjerman FES dhe fondacionin suedezi OPC, partnerin tonë strategjik sindikaten gjermane Ver.di, "Solidarity Center" te konfederates Amerikane, Federatën tone Nderkombetare UNIGlobal Union dhe cdo partner tjeter me te cilin kemi bashkepunuar gjate ketij viti. Një falenderim dhe vlerësim u takon të gjithë kolegëve të strukturave të SPPTSH-së, që kanë punuar me seriozitet për të përfaqësuar denjësisht të gjithë punonjësit e seksioneve dhe rajoneve të tyre.

Gjithsesi dua të theksoj edhe njëherë se puna janë për të rritur dhe forcuar këtë sindikatë do të vazhdojë. Ne do të vazhdomë të ndjekim planin tonë strategjik dhe të luftojmë për të ndërtuar një sindikatë moderne në shërbim të të gjithë anëtarëve. Sa më shumë të solidarizohemi me sindikaten aq me shume i sherbejme zgjidhjeve te kauzave tona. Sindikata eshte njesoj si ekipi juaj i futbollit që futet ne fushen e lojes vetem per te fituar pavaresisht se si perfundon ndeshja. Ndersa anetaret janë tifozet e saj te zjarre që e ndihmojnë ne cdo ndeshje. Prandaj mbeshtetja per sindikaten duhet te jetë gjithmonë pa kushte ashtu sic mbeshtetet skuadra e zemres ne futboll. Sindikata eshte ekipi jone fitues!

Sinqerisht,
Renato MUÇAJ
Kryetari SPPTSH-së



KONFERENCA E TELEKOMUNIKACIONIT

Sindikata Shqiptare e Postë-Telekomit në bashkëpunim me Fondacionin "Friedrich Ebert" dhe Sindikatën Gjermane Ver.di organizoi më datën 16 Tetor 2018 në Hotel Rogner konferencën "Zhvillimet Globale në Sektorin e Telekomunikacionit dhe Sfidat për Shqipërinë".



Në vitet e shkuara sektori i telekomunikacionit ka ndryshuar vazhdimesht, madje ende nuk mund të thuhet se kur do të marrin fund këto ndryshime. Kompanitë e sektorit të telekomunikacionit gjenden sërish para ndryshimeve vendimtare dhe aktualisht të ndodhura nën presion të lartë -me dallime të qarta për sa i takon pikënisjes dhe ritmit - janë duke ndërmarrë një sërë aktivitetesh ambicioze, si:

- të realizojnë me sukses zgjerimin e shpejtë të rrjeteve infrastrukturore me kapacitete transferuese (FTTx, 5G) si nga pikëpamja financiare, organizative dhe e personelit me qëllim që të përballojnë fluksin në rritjen të të dhënave që pritet të ndodhë në kuadër të aplikimeve VR dhe IoT1;
- të instalojnë modele të reja të prodhimit (SND, NFV), për të shfrytëzuar më mirë mundësitë e përshtatshmërisë së rrjeteve me bazë IP;
- të përshpejtojnë ristrukturimin në "digital telcos", me qëllim rritjen e efikasitetit operativ dhe përmirësimin e përvojës së konsumatorit "customer experience";
- të eksplorojnë fusha të reja të biznesit, në mënyrë që të mos lihen në hije nga ofruesit e shërbimeve OTT duke u reduktuar thjesht në përcjellës (bit-pipes).
- të çojnë përpara konsolidimin e sektorit në nivel kombëtar e ndërkombëtar, për të shfrytëzuar më mirë efektet e sinergjisë dhe për të ulur presionin e konkurencës;
- të përmirësojnë mjedisin rregullator, për të luajtur në të njëjtat nivele me koncernet e internetit si Google dhe Facebook.





Në kushtet e sotme ende nuk mund të thuhet, nëse kompanitë e këtij sektori do të përmbyllin me sukses përpjekjet e tyre. Jo më kot kompania e konsulencës Deloitte ka bërë një studim rreth së ardhmes së kompanive të sektorit të telekomunikacionit me titullin "Të jesh, a të mos jesh". Sidoqoftë një gjë dihet me siguri: risitë që pritet të ndodhin, i vënë këto kompani përparrë sfidave të mëdha për sa i takon menaxhimit dhe burimeve njerëzore, ndër të tjera edhe në lidhje me çështje të sigurimit të vendeve të punës dhe të kualifikimit. Ndaj për kapercimin e tyre nevojiten kompetenca të gjithashme, bashkëpunim konstruktiv dhe perspektiva të përbashkëta. Po ashtu edhe tregu Shqiptar i telekomunikacionit nuk ka mbetur jashte ketyre ndryshimeve. Një nga ndryshimet kryesore të ndodhura në tregun celular ishte mbyllja e aktivitetit të ofrimit të shërbimeve celulare nga operatori "Plus Communication" më datë 31.12.2017. Nje kompani tjetër Telekom Albania u shit. Telekom Serbia kërkoi të blej "Telekom Albania". Nje alarm u ngrit jo vetem brenda tregut por dhe ne rrafshin kombetar duke e kthyer sektorin e telekomunikacionit ne kryefalen e te gjithe opinionit publik. Kjo çështje ngriti pyetje nese kjo gjë rrezikon apo jo sigurinë kombëtare? A ishte kjo përpjekje e influences Ruse për të hyrë në një sektor strategjik sic eshte telekomunikacioni? A duhej Presidenti me ane te Keshillit te Sigurisë Kombetare te ndalon te kete transaksion? A rrezikoheshin te dhenat e abonenteve Shqiptar? Por pervec këtyre pyetjeve vetëm për punonjësit nuk pyeste njeri. Po me punonjesit e Telekom Albania cdo te ndodhë? Do pushoheshin? Do zevendesoheshin? Apo i priste i njejtë fat si punonjesit e Plusit. Për këto arsyë u vendos zhvillimi i nje konference pikërisht ne kete kohe per te dhene një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim.

Qëllimi i konferences ishte:

- të diskutonte rreth transformimit të sektorit të telekomunikacionit në nivel global dhe europian.
- të nxirrte në pah, se në ç'masë zhvillimet në shkallë ndërkombëtare janë me rëndësi për Shqipërinë dhe ç'masa duhet të merren në vend.
- të hartonte propozime për zgjidhjen e problemeve të orientuara nga e ardhmja në të mirë të të gjitha kompanive shqiptare të sektorit të telekomunikacionit dhe të punonjësve të tyre.



Në konferencë morën pjesë përfaqësues të Qeverisë, Parlamentit, AKEP, përfaqësues të Kompanive, Punonjës dhe të ftuar, si dhe përfaqësues ndërkombëtarë të fushës së telekomunikacionit. Konferencia ishte konceptuar ne dy pjesë ku ne fillim do te flisin te gjithe aktoret me rradhe duke shprehur kendshveshtrimet e tyre, dhe në pjesën e dyte një panel gjithëpërfshirek do te diskutonte mbi qasjet e perbashketa. Në përfundim te punonjëve konferanca synonte hartimin e një rezolutë që do u dërgohej të gjithë institucioneve, kompanive dhe punonjësve të sektorit.



Moderatori konferencës z. Fatos Cocoli, pasi bëri prezantimin e konferencës ja dha fjalën pershendetese. z. Genci Lamlli - Perfaqësues i fondacionit Friedrich Ebert Stiftung (FES). z. Lamlli theksoi rendesine e konferencës si një nisem shume e mire e ndermarr nga SPPTSH ne kohen e duhur dhe e mbështetur me kenqesi nga fondacioni, si një pune e vertet sindikale, ku kerkohet perqatitje për të gjitha sfidat që priten te perballat ky sektor ne te ardhmen. Konferencen e pershendetet znj. Teresa Casertano, Drejtuese e Departamentit të ICTS-së në Federatën Ndërkombëtare, UNI Global Union. Si një sindikaliste me ekperience, znj. Casertano shprehu mbështetjen e vazhdueshme që UNI Global Union e cila është ndër federatat më të mëdha ne fushen e aftesive dhe shërbimeve dhe përfaqëson rreth 20 milion punonjës, në 150 vende të ndryshme ka dhene per anetaren e saj sindikaten e SPPTSH-së dhe angazhimin e tyre ne Shqipëri edhe ne sektor te tjere sic eshte ai i call center.



Me pas z. Ado Vilhem, si perfaqësues i sindikates gjermane Ver.di, dhe personi i perfshire drejtëperdrejte ne organizimin e konferencës foli per partneritetin që SPPTSH ka nisur me Ver.din dhe punen e ngushte per rritjen e kapaciteteve dhe per forcimin e sindikates tone per te organizuar vende te reja pune. Koleget e Ver.di kane qene një mbështetje e forte gjate ketyre dy viteve duke ndare eksperiencen e tyre ne Gjermani, ku ata janë një nder sindikat me te fuqishme me rreth 2 Milion anetare. z. Ado Vilhem ka udhehequr kete partneritet dhe ka pasur një kontribut personal per zhvillimin e kesaj konference.

Kryetari i sindikates z. Renato Muçaj ne fjalën e tij hapese, bëri një prezantim te punës se sindikates dhe deklaroi se ndihej krenar per nismen që sindikata kishte ndërmarrë per organizimin e kesaj konference per here te pare ne sektorin e telekomunikacionit. Ai konkretisht deklaroi: "Kur hodhem idene e kesaj konference, deshironim që te kishim një gjithe perfshirje te te gjithe aktoreve ne kete sektor ku gjithsejili te jepë inputin e tij per zhvillimet e sektorit. Besoj se ja kemi arritur duke i bere bashke te gjithe aktoret". Me pas z. Muçaj i fttoi te pranishmit te perdornin teknologjine, telefonat e tyre smart duke i ftuar te votonin elektronikisht se cila ishte pritshmeria e tyre ne konference pasi ishte shume e rendësishme perfshirja e audiences dhe nderveprimi i tyre gjate konferencës.



Mbas fjaleve pershendetese z. Achim Fischer - Ekspert i telekomunikacionit te Deutsche Telekom beri nje pasqyrim te trendeve me te fundit nderkombetar. z.Fischer solli disa nga planet e Deutsche Telekom mbi transformimin e sektorit të telekomunikacionit në nivel global dhe europian. Po ashtu ai theksoi se keto trende duhet te ndiqen me kujdes si nga kompanite ketu, por gjithashtu duhet te studiohen edhe nga sindikatat ne menyre qe te ndihmojne punonjesit gjate transformimeve.

Ndersa nga Autoreteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare z. Pajtim Melani beri nje rezume te situates kombetare duke prezantuar raportin e autoritetit por dhe trendet e reja, problemet aktuale dhe sfidat e tregut shqiptar te telekomunikacionit.

z. Renato Mucaj - referoi mbi problemet aktuale dhe zgjidhjet nga këndvështrimi i sindikatës, duke nenvizuar edhe njeher ceshtjen e punonjesve, sepse kjo ka qene dhe arsyea qe sindikata ka marre iniciativen per nje konference te tille pasi risitë që pritet të ndodhin, do i vënë këto kompani përparrë sfidave të mëdha për sa i takon menaxhimit dhe burimeve njerëzore, ndër të tjera edhe në lidhje me çështje të sigurimit të vendeve të punës dhe të kualifikimit. Ndaj lind nevoja qe dhe Shqiperia te kete nje plan strategjik. Ai gjithashtu shpjegoi edhe strategjine e re të sindikatës për ti grupuar të gjithë kompanitë e sektorit të postave dhe telekomunikacionit nën Sindikatën e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar.

Problemet aktuale dhe sfidat nga këndvështrimi i operatorëve të telekomunikacionit u trajtuan ne pjesen e dyte nga perfaquesuesit e kompanive telefonike. Me pas u zhvillua nje diskutim ne panel qe u moderua nga z. Fatos Cocoli (moderator). Ne panelin e diskutimit merrnin pjese:

- z. Renato Mucaj - Kryetar i SPPTSH
- z. Dajna Sorensen - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë
- z. Luljeta Krasta - Përfaqësuese e Drejtorisë së Marrëdhënieve të Punës
- z. Ado Vilhem - Përfaqësues i Ver.di
- z. Achim Fischer - Ekspert i Telekomunikacioni i DT
- z. Indrit Daci - Përfaqësues i Albtelecom.

 <p>SPPT – Sindikata e punonjësve Postë –Telekom Albanian Trade Union of Post-Telecom Workers Affiliated to UNI Global Union</p> <p>Nr. <u>39</u> Prot. Tirana, më 5 / 11 / 2018</p> <p>Lëndë: <u>Dërgimi i Rezolutës së Konferencës nderkombëtare "Zhvillimet globale në sektorin e telekomunikacionit së sfidat për Shqipërinë", zhvilluar në Tiranë më 16 tetor 2018</u></p> <p>Drejtuar: <u>Z. Edi RAMA KRYMINISTRË</u> <u>TIRANË</u> <u>Z. Gramoz RUÇI KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPÉRISË</u> <u>TIRANË</u> <u>Z. Eduard SHALSI KRYETAR I KOMISIONIT PËR VEPRIMTARITË PRODHUESE, TREGTINE DHE MJEDISIN</u> <u>TIRANË</u> <u>Z. Damjan GJIKNURI MINISTRË I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJITIKËS</u> <u>TIRANË</u> <u>Z. Arben AHMETAJ MINISTRË I FINANCAVE DHE EKONOMISË</u> <u>TIRANË</u> <u>Z. Ilir ZELA KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES TË A.K.E.P.</u> <u>TIRANË</u> <u>Z. Tahsin YILMAZ DREJTOR I PËRGJITHSHËM I ALBTELCOM</u> <u>TIRANË</u> <u>Z. Achilles KANARIS DREJTOR I PËRGJITHSHËM I VODAFONE ALBANIA</u> <u>TIRANË</u> <u>Z. Dimitris BLATSIOS DREJTOR I PËRGJITHSHËM I TELEKOM ALBANIA</u> <u>TIRANË</u> <u>Z. Gent DACI DREJTOR I PËRGJITHSHËM I ABCOM</u> <u>TIRANË</u> <u>Znj. Herjetë DELIAJ DREJTOR I PËRGJITHSHËM I ABISSNET</u> <u>TIRANË</u></p>	 <p>SPPT – Sindikata e punonjësve Postë –Telekom Albanian Trade Union of Post-Telecom Workers Affiliated to UNI Global Union</p> <p>Znj. Juliana GURI DREJTOR I PËRGJITHSHËM I ASC <u>TIRANË</u></p> <p>Z. Marin GJONAJ DREJTOR I PËRGJITHSHËM I DIGICOM <u>TIRANË</u></p> <p>Z. Wulf LAPINS DREJTOR I FONDACIONIT GJERMAN "FRIEDRICH EBERT" <u>TIRANË</u></p> <p>Znj. Zhulita HARASANI KORDINATOR KOMBËTAR ILO ALBANIA <u>TIRANË</u></p> <p>Znj. Christy HOFFMAN SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I FEDERATES NDËRKOMBËTARE "UNIGLOBAL UNION" <u>NYON, ZVICËR</u></p> <p>Z. Ado WILHELM SINDIKATA GJERMANE "VER.DI" <u>BERLIN, GJERMANI</u></p> <p>Z. Laurence CLEMENTS "SOLIDARITY CENTER" – KONFEDERATA AMERIKANE "AFL-CIO" <u>WASHINGTON, USA</u></p> <p>Sindikata e Punonjësve të Post-Telekomit të Shqipërisë, e shqetessuar ndaj problematikës dhe sfidave të punësimit në sektor, organzoit në Tiranë më 16 tetor 2018 Konferencën nderkombëtare "Zhvillimet globale në sektorin e telekomunikacionit së sfidat për Shqipërinë".</p> <p>Po Ju përcjellim bashkëlidhur Resolutën e miratur e njëzëri nga pjesëmarrësit e Konferencës, përfaqësues të ministrave të linjës, kompanive kryesore veprimore të sektorit, sindikatës gjermane të telekomunikacionit Ver.di, shqipërisë civile, etj., me shpresë se Ju do të kontribuoni në një dialog të hapur mes vendin-marrësve publike ekonomikë, sipërmarrës private në sektor dhe Sindikatës sëmë, për një zhvillim të qëndrueshëm dhe progres i të mësuarëm të tregut të komunikimeve elektronike të Shqipërisë, duke ruajtur një rithem të shëndëshëm punësimi qe pa pasojë të rëndë sociale.</p> <p style="text-align: right;">KRYETAR Renato MUCAJ</p> <p>Br. "Myftimi Shqip", nr. 42 Tiranë Albania Website: www.spptsh.com Email: info@spptsh.com Tel: +35542290315</p>
--	---



Diskutimet e panelit u fokusuan mbi mundësitë e qasjeve të përbashkëta nga operatorët e telekomunikacionit, të punonjësve, sindikatave dhe politikës për sektorin e telekomunikacionit. Te gjithe ndane mendimin se për kapercimin e tyre nevojiten kompetenca të gjithashme, bashkëpunim konkstruktiv dhe perspektiva të përbashkëta. Prandaj kjo konference ishte pikënisja e një dialogu te gjere me të gjithe aktoret perjegjes dhe hartimi i një strategjie kombetare gjithëpërfshirëse për të mbrojtur punonjesit e telekomunikacionit ishte kryefjala e diskutimeve gjatë konferencës. z. Muçaj gjithashtu i kerkoi znj. Dajna Sorensen - zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, perfshirjen e Sindikates se Punonjësve te Poste-Telekomit Shqiptar ne Keshillin Kombtar te punes si perfaqesues i punemarresve per te perfaqesuar interesat e punonjësve te ketij sektori.

Ne konference merrnin pjesë dhe shume te ftuar te tjere si : Z. Laurie Clements - Drejtori Rajonal i Qendres se Solidaritetit te Konfederates Amerikane, Presidenti i Sindikates Greke OME-OTE- Z. Vasilis Lamprou dhe te gjithe koleget e kesaj sindikate, Znj. Plejada Gugashi-Fondacioni Suedez Olof Palme Center, Perfaqesues nga Sindikatat e huaja dhe Shqiptare, si edhe Organizata mike e partnere. Në përfundim te punimeve konferencia hartoij një rezolutë që ju dërgua të gjithë institucioneve, kompanive dhe punonjësve të sektorit.

Konferanca e Telekomunikacionit pati një impakt te madh duke u pasqyruar ne kronikat e disa prej mediave kryesore ne vend. Me poshte ndodhen emrat e disa prej televizioneve ku u pasqyruan keto kronika:



TOP CHANNEL

GAZETA SHQIP

CITIZEN CHANNEL

SCAN TV

LAPSI.AL

FAX.AL

ORA NEWS

MAPO.AL

DRITARE.NET

REZOLUTA - RESOLUTION

16/10/2018



Sindikata e Punonjesve te Post Telekomit Shqiptar

Albanian Trade Union of Post-Telecom Workers

REZOLUTË

Ne, pjesëmarrësit në Konferencën ndërkontinentare me titull “Zhvillimet globale në sektorin e telekomunikacionit dhe sfidat për Shqipërinë”, të ndërgjegjësuar ndaj problematikës dhe sfidave të sektorit, miratojmë Rezolutën si vijon.

Duke parë:

1. Një sektor telekomunikacioni si në botë ashtu dhe në Shqipëri, në ndryshim radikal dhe të vazhdueshëm, veprimtarët e të cilët ndodhen sërisht përpara ndryshimeve vendimtare dhe nën presion të lartë;
2. Domosdoshmërinë e zgjerimit të shpejtë të rrjeteve infrastrukturore me kapacitete transfereuse (FTTx, 5G) si nga pikëpamja financiare, organizative dhe e personelit, me qëllim që të përballojnë fluksin në rritjen të të dhënave që pritet të ndodhë në kuadër të aplikimeve VR (të realitetit virtual) dhe të IoT(gjithërrjetit);
3. Domosdoshmërinë e instalimit të modeleve të reja të prodhimit (SND-rrjeti i përcaktuar nga programe kompjuterike- dhe NFV-virtualizimi i funksionit të rrjetit), për të shfrytëzuar më mirë mundësitet e përshtatshmërisë së rrjeteve me bazë ofrimin e internetit;
4. Domosdoshmërinë e investimeve shtetërore nga të ardhurat e shitjes së frekuencave në modernizimin e rrjetit të telekomunikacionit, për futjen e teknologjive të reja, nën shembullin e eksperiencës së vendeve të Bashkimit Evropian;
5. Rrezikun e lënies në hije nga ofruesit e shërbimeve OTT(over the top-mbi majën), kryesisht filma, televizion dhe muzikë drejtpërsëdrejti tek konsumatori;
6. Domosdoshmërinë dhe oportunitetin e shndërrimit të kompanive të telekomunikacionit në digital telcos(kompani telekomunikacioni dixhitale), për të ofruar shërbime tregtimi(shitje me pakicë) online, E-healthcare (shërbime kujdesi shëndetësor virtual), E-shërbime financiare, E-maps, shërbime udhëtimi online, etj.
7. Riskun e humbjes masive të vendeve të punës në një sektor që sot punëson mbi 18 mijë vetë nga mos-shndërrimi në kohë në digital telcos i kompanive të sektorit;
8. Mungesën e një vizioni, strategjie dhe plani veprimi të qartë gjithëpërfshirës për sektorin;
9. Dëshirën për dialog konstruktiv dhe bashkëpunim konkret të shprehur nga përfaqësuesit e lartë të Ministrisë së Infrastrukturës dhë Energjisë dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të pranishëm në Konferencë;
10. Praninë e ekspertizës së çmuar të Sindikatës Gjermane Ver.di, sindikatës më të madhe në Europë (me 2 milion anëtarë) të sektorit të telekomunikacioneve dhe vullnetin e përfaqësuesve të Ver.di për të ndihmuar në çdo hap Sindikatën e Post-Telekomit Shqiptar,

I kërkojmë:

I. Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të Kuvendit të Shqipërisë të kërkojë nga Qeveria dhe përkatësisht nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:

- I.1. të përgatisë, në bashkëpunim me Komisionin, me veprimtarët e sektorit, me Sindikatën e Post-Telekomit Shqiptar dhe me shoqërinë civile Strategjinë afatmesme 2019-2023 të Zhvillimit të Telekomunikacionit, si dhe Planin përkatës të Veprimit;

I.2. t'i kërkojë Qeverisë dhe Ministri i Punës përkatëse që të nxisin lidhjen e kontratës kolektive të punës nga ana e punëdhënësve(kompanive) që ende nuk e kanë lidhur dhe punëmarrësve(Sindikatës) për punonjësit e kompanive të telekomunikacionit. Kjo kontratë do të jetë baza për sigurimin e vendit të punës dhe të kualifikimit të kerkuar për përballimin e sfidave të reja të sektorit;

I.3. në rastin e shkurtimeve të pashmangshme të vendeve të punës për shkak të implementimit të teknologjive të reja në sektor, të kërkojë, përpresa kryerjes së këtyre shkurtimeve, përgatitjen dhe miratimin nga Qeveria të një pakete sociale specifike në ndihmë të punonjësve të shkurtuar.

I.4. t'i kërkojë Qeverisë të zhvillojë forma partneriteti me kompanitë e sektorit për shërbimet e-government, e-health, e-tatime, e-education, etj., si dhe të luftojë më me eficiencë informalitetin e sektorit.

II. Qeverisë së Shqipërisë:

II.1. të përgatisë dhe miratojë, në bashkëpunim me veprimtarët e përmendur më lart, Strategjinë afatmesme 2019-2023 të Zhvillimit të Telekomunikacionit, si dhe Planin përkatës të Veprimit. Sindikata e Post-Telekomit Shqiptar është duke përgatitur një Strategji dhe Plan Pune alternativ, përtorat e orientuar Qeverinë;

II.2. të nxisë lidhjen e kontratës kolektive të punës nga ana e punëdhënësve(kompanive) dhe punëmarrësve(Sindikatës) për punonjësit e kompanive të telekomunikacionit, e cila do të jetë baza për sigurimin e vendit të punës dhe kualifikimit të kerkuar për përballimin e sfidave të reja të sektorit. Shumë shpejt Sindikata do të paraqesë një draft të Kontratës Kolektive të Punës, përtorat e diskutuar me kompanitë punëmarrëse të sektorit dhe shpreson mbështetjen e Qeverisë në këtë drejtim;

II.3. në rastin e shkurtimeve të pashmangshme të vendeve të punës për shkak të implementimit të teknologjive të reja në sektor, të përgatisë, përpresa kryerjes së këtyre shkurtimeve, një paketë sociale specifike në ndihmë të punonjësve të shkurtuar, përtorat e miratuar dhe bërë operative në momentin e kryerjes së shkurtimeve;

II.4. të zhvillojë forma partneriteti me kompanitë e sektorit për shërbimet e-government, e-health, e-taxation, e-education, etj., si dhe të luftojë më me eficiencë informalitetin e sektorit.

III. Kompanive të sektorit:


III.1. Për ato kompani që nuk e kanë lidhur kontratën kolektive, së bashku me Sindikatën e Post-Telekomit Shqiptar, të miratojnë dhe vënë në zbatim Kontratën kolektive të Punës për punonjësit e sektorit brenda një periudhe të shkurtër kohore;

III.2. Të marrin pjesë aktivisht si në përgatitjen e Strategjisë alternative të Zhvillimit të Telekomunikacionit të Sindikatës së Post-Telekomit Shqiptar 2019-2023 dhe Planit përkatës të Veprimit, ashtu edhe të Strategjisë afatmesme 2019-2023 të Zhvillimit të Telekomunikacionit të Qeverisë së Shqipërisë, në rast se kjo e fundit do të angazhohet në përgatitjen e një strategjie të tillë.

Takim me perfaqesues te Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise


Me date **27.11.2018** me kerkese te Sekretarit te Pergjithshem te Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise (MIE), z. Gentian Këri, në mjeshteret e MIE një perfaqesi e Sindikatës u takua me zj. Irena Malolli, drejtore e Politikave dhe Strategjive te Zhvillimit te Telekomunikacionit dhe Postave. MIE shprehu interes per hartimin e politikave dhe programeve per zhvillimin e metejshem te sektorit.

Nga Sindikata, ndergjegjesuam MIE per sfidat e renies se mundshme te punesimit ne sektor (daljen ne mes te kater rrugeve te punonjesve) nga rreziku i tkurjes dhe deshtimit te kompanive te telekomunikacionit per t'u shndërruar në kompani dixhitale (digital telcos). Theksuan se te mbeshtetur nga ekspert lokal, nga Fondacioni Friedrich Ebert dhe ne keshillim me specialist te Sindikates gjermane te Telekomunikacionit Ver.di, kemi marre persiper hartimin e një strategjje alternative te sektorit 2019-2023, me theks ne politikat e riaftesimit te punonjesve te sektorit te telekomunikacionit e cila ka si qellim ruajtjen e vendeve te punes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË



Krahas kesaj, me kete Strategji alternative, draftin e se ciles do ta diskutojme me partneret tanë, perfaqesueset e MIE theksuan se Sindikata eshte një veprimtare dhe partnere e natyrshme e planit te veprimit per zbatimin e Strategjise “Akhenda Dixhitale e Shqiperise 2015-2020” ne fushen e telekomunikacionit. MIE mirepriti orientimin e strategjise alternative te Sindikates per t'u krijuar mundesi kompanive te sektorit te telekomunikacionit te ofronin sherbimet e tyre per masivizimin e produkteve te qeverisjes elektronike E-Government. Nga Sindikata theksuan se, me perfundimin e draftit te pare te strategjise tone alternative ne Dhjetor 2018, do ta ndajme ate me MIE per feedback dhe konsultime te metejshme, si dhe me partneret e tjere. Takimi i hapi rrugen një korrespondence dhe bashkepunimi edhe me intensiv te Sindikates me MIE.

**“Akhenda
Dixhitale
e Shqiperise
2015-2020”**



Mbledhja e sindikatave te Aleances OTU - One Telekom Union - ne Tirane

Ne 14-15 Tetor 2018 ne Tirane u zhvillua mbledhja e sindikatave te Aleances OTU- One Telekom Union- me mbeshtetjen e fondacionit gjerman Friedrich Ebert Foundation Tirana dhe me pjesemarrjen e federates nderkombetare UNI Global Union dhe Sindikatave te telekomunikacionit pjesa e kesaj aleance: Sindikates Gjermane ver.di, Sindikates Austriake, Sindikates Greke, Sindikates Rumune, Sindikate Hungareze, Sindikates Kroate, Sindikates Malazeze, Sindikates Polake, Keshilit European te Puntoreve (EWC) dhe Sindikata e Punonjesve Poste-Telekomit Shqiptar SPPT. Kjo mbledhje diskutoj mbi zhvillimet e fundit te Grupit Deutsche Telekom dhe nje sere ceshtje mbi sektorin e telekomunikacionit. Ne kete mbledhje moren pjese edhe perfaquesues te larte te Deutsche Telekom. Ne perfundim te mbledhjes dy ditore, Aleanca One Telekom Union doli me nje deklarate per shtyp. Kjo mbledhje i parapriu konferences se sektorit te telekomunikacionit te dates 16 Tetor 2018 ne Hotel Rogner.



Deklarata e takimit të OTU në Tiranë në Tetor 2018

Formimi i së ardhmes, hapja e perspektivave të reja, marrja e përgjegjësisë
Me One Telekom Europe, strategjia dhe qëllimi i Deutsche Telekom është të bëhet kompania lider
e telekomunikacionit në Evropë.

Në qershor 2016 në Budapest, sindikatat e lidhur me UNI vendosën të përgjigjen duke krijuar një
aleancë sindikale, One Telekom Union (OTU). Ky ishte një vendim themeltar i cili duhet të ndiqet
dhe zhvillohet. Takimi i mbajtur në Tetor 2017 në Mal të Zi ka qenë një moment historik në rrugën
drejt një aleance të fortë sindikale.

Deutsche Telekom Group AG po bëhet gjithnjë e më globale. Kjo vlen edhe për organet e saj ven-
dimmarrëse dhe transferimin e përgjegjësive. Vendimi i janarit 2019 për krijimin e një segmenti
bordi për Sh.B.A dhe Zhvillimi është një tregues shtesë i këtij fakti.

Industria e telekomunikacionit është në prag të një konsolidimi të shpejtë dhe global i cili do të ketë
një ndikim të fortë në telekos evropian në përgjithësi, dhe në veçanti Deutsche Telekom. Ndrys-
himet teknike, masat organizative dhe ndikimi i tyre në jetën e njerëzve nuk ndalen në kufijtë kom-
bëtar. Për më tepër, të drejtat e pjesëmarrjes së punonjësve dhe strukturat e përcaktimit po ndrysho-
jnë.

Eshtë e domosdoshme që të gjithë ata që kanë përgjegjësi të mbrojnë interesat e punëtorëve (UNI,
sindikatat, këshillat e punës, EWC) të kuptojnë rëndësinë e rritjes së bashkëpunimit dhe zhvillimit
të rrjeteve. Kjo është diçka që duhet të ndiqet me këmbëngulje.

Në takimet e Budapestit 2016 dhe Malit të Zi 2017 u pajtuam për një seri qëllimesh të përbashkëta
të cilat përfshinin:

- Të përfshihet në një fazë të hershme në të gjitha vendimet e marra nga One Telekom Europe
- Zhvillimi i strategjive të përbashkëta për të mbrojtur interesat e punëtorëve
- Miratimi i një qasjeje të koordinuar
- Shkëmbimi i informacionit rregullisht
- Duke kërkuar të ndikojë në rregulloret evropiane që prekin tregjet e telekomit
- Përdorimi më i mirë i EWC për të zgjeruar të drejtat e punëtorëve

Sigurisht që interesat kombëtare duhet të lihen mënjanë dhe të gjitha përpjekjet duhet të përqen-
drohen në përparimin e qëllimeve tona të përbashkëta. Përveç qëllimeve tona të mëparshme, një
qëllim tjetër është që OTU të njihet nga Deutsche Telekom si një partner negociator. Kompanitë
globale kanë nevojë për përgjigje sindikale globale dhe veprime sindikale globale që promovojnë
solidaritetin. One Telekom Union është përgjigja dhe baza për unitetin tonë të veprimit dhe soli-
daritetit. Në Budapest dhe Podgoricë aleanca ra dakord që solidariteti dhe bashkëpunimi midis
sindikatave, këshillave të punës, Këshillit Evropian të Punëve dhe përfaqësuesve të punonjësve në
bordet mbikëqyrëse të kompanive kombëtare duhet të thollohen, zgjerohen dhe optimizohen. Një
nga objektivat tanë kryesorë është të përdorim të gjitha mundësitë dhe levat që ekzistojnë në vende
të ndryshme për të zgjeruar të drejtat dhe mundësitë që EWC të kryejnë punën e tyre. Ky është një
nga aspektet kryesore të detyrës që qëndron përpara. Për të arritur këtë qëllim, duhet të përcaktohet
një program i përbashkët veprimi dhe duhet të krijohet një grup pune për të zhvilluar këtë plan.





OTU vëren se përballur me transformimin e veprimitarive të DTAG, si dhe konsolidimin e afërt të industrisë së telekomunikacionit, solidariteti dhe mbështetja e ndërsjellë duhet të jenë baza për mbrojtjen dhe sigurinë e punonjësve në filialet kombëtare që përbëjnë pjesë të rrjetit evropian të Telekom. Ndarja e T-Systems e cila akoma nuk është përfaqësuar në OTU duhet të integrohet gradualisht në punën tonë.

UNI do të krijojë një listë të vendeve në Evropë në të cilat T-Systems është aktiv dhe në të cilat sindikatat e lidhura me UNI përfaqësojnë anëtarët / punonjësit. Këto organizata do të kontaktohen sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të informohen për OTE dhe qëllimet e tij. Qëllimi është një integrim i shpejtë dhe nëse është i mundur i plotë në OUT, me qëllim zbatimin e këtij procesi deri në fund të tremujorit të dytë të 2019-ës.

Përbërja e grupit drejtues duhet të përshtatet me kushtet e reja. Diskutimet me menaxhimin e Grupit dhe vendimmarrësit në filialet kombëtare ende nuk kanë qenë të suksesshme. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të menaxhmentit në mbledhjen e Malit të Zi dhe në takimet e mëposhtme të grupit drejtues OTU është një zhvillim që ne e mirëpresim por që duhet të shkojë drejt angazhimeve më detyruese. OTU duhet të pranohet si një partner diskutimesh dhe bisedimesh për çështjet kryesore në Evropë. Grupi Drejtues duhet të zhvillojë mekanizmat e nevojshëm për të siguruar marrëveshje detyruese me menaxhimin e Grupit. Anëtarët e aleancës bien dakord që bashkëpunimi midis OTU dhe Grupit duhet të përqëndrohet në çështje të gjera të politikave dhe nuk duhet të përfshihet në pyetje që kanë rëndësi thjesht kombëtare.

Hapat e ardhshëm për të vazhduar dhe thelluar dialogun drejt bërjes së një partneri të pranuar të negociatave me Grupin dhe filialet kombëtare përfshijnë identifikimin e çështjeve dhe pyetjeve përkatëse të cilat janë shkaktuar nga konsolidimi dhe zhvillimet e sektorit TIK. Aleanca sindikale ofron një dialog të drejtë të frysmezuar nga një ndjenjë e përgjegjësisë dhe imagjinatës politike. Si kthim, pret që kompania mëmë e DTAG dhe filialet rajonale të vazhdojnë të thellojnë diskutimin dhe të përfundojnë një marrëveshje për bashkëpunim. Mirëqenia dhe zhvillimi i kompanisë dhe punonjësve të saj duhet t'i jepet një vlerë e barabartë, dhe të gjitha vendimet që ndërmarrja synon të marrë duhet të shqyrtohen për të siguruar që ata gjithashtu të marrin parasysh shqetësimet e punonjësve që kanë të drejtë të trajtohen me respekt, drejtësi dhe kujt duhet t'i ofrohet një perspektivë për të ardhmen.

Përfshirja e OTU dhe sindikatave rajonale si një zë i të punësuarve në lidhje me trajtimin dhe zhvillimin e çështjeve dhe pyetjeve të ardhshme duhet të sigurohet nga Grupi dhe filialet kombëtare.

Tiranë, 15 Tetor 2018



Takimi i Kryetarit te SPPTSH-se z.Renato Mucaj dhe z. Srin Gopalan, Anetar i Bordit Drejtues te Deutsche Telekom AG per Europen.

Në kuadër të aleancës të Deutsche Telekomit OTU (One Telekom Union) për organizimin e sindikatës në Telekom Albania, Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar ne partneritet me sindikaten Gjermane Ver.di, mbështetur edhe nga Fondacioni Gjerman FES, në datat 4-8 Qershor 2018 ka zhvilluar një vizite ne Berlin me qellim lobimin dhe ndergjegjesimin e te gjitha paleve per problemet qe Sindikata jone ka hasur ne perpjekjet per zhvillimin e nje dialogu social te shendetshem. Në këtë vizite ne daten 4 Qershor Kryetari i SPPTSH-se eshte takuar me anetarin e **Bordit drejtues te Deutsche Telekom AG per Europen z. Srin Gopalan ne Bonn, Gjermani**. Ky takim i ndermjetesuar nga Kryetari i Sindikates Gjermane te telekomunikacionit z. Lothar Schroder u zhvillua ne nje klime teper miquesore, ku z. Gopalan ju be nje pasqyrim i te gjithe zhvillimeve qe Sindikata jone ka pasur me menaxhimin lokal ne Tirane. Z. Gopalan u informua edhe per takimet e zhvilluara midis Sindikates dhe Menaxhmentit te Telekom Albania si dhe per fushatat e nderrmara nga sindikatët te Telekom, si organizuar ne sindikate ne lidhje me shprehur informave qe broshurave informative ne lidhje me zhvillimet e zhvillimeve qe organizuar ne sindikate ne lidhje me zhvillimet e zhvillimeve qe organizuar ne sindikate ne lidhje me zhvillimet e zhvillimeve qe organi
z. Mucaj i kerkoi z. Gopalan qe me autoritetin e tij te nderhyj, jo per favorizime por per nxitje te metejshme te menaxhimit ne Tirane per zhvillimin e nje dialogu social te sinqerte, per ruajtjen e neutralitetit dhe mos pengimit te aktivitetave te sindikates, te cilat kane si piken ku ne si pale do te deshironim le ishë: dha per ruajtjen e neutralitetit dha mos pengimit te aktivitetave te sindikates, te cilat kane si qellim informimin e punonjësve.Në vazhdim duhet te jene vet punonjësi, te cilat do te deshironim le ishë: dha per ruajtjen e neutralitetit dha mos pengimit te aktivitetave te sindikates, te cilat kane si qellim informimin e punonjësve.Në duan apo jo që ti bashkohen sindikates, z. Mucaj gjithashtu e njoju z. Gopalan edhe me iniciativen qe SPPTSH ka nderrmarr per organizimin e një konference mbi sektorin e telekomunikacionit me operatorët Albtelecom, Telekom Albania, Vodafone Albania dhe operator te tjere kombetar ku do diskutohet per sfidat dhe ndryshimet qe priten ta prekin kete sektor si ne zhvillimet teknologjike ashtu që vendet e punës. Ne perfundim te takimit z. Gopalan dhe Drejtoresha e Burimeve njerezore per Europen znj. Eva Somorjai rane dakort qe te komunikojne serish me menaxhimin ne Tirane te Telekom Albania, per te nxitur dialogun social qe edhe pse ka pasur disa zhvillime nuk ka arritur akoma rezultatet ne nivelin e duhur. Znj. Somorjai gjithashtu cilesoi konferencen e sektorit si nje moment shume te mire, te cilin drejtuesit e Telekom Albania mund ta shfrytezojne per zhvillimin e metejshem te dialogut social midis paleve.

shperndarjen e broshurave informative ne lidhje me te drejtat e punonjësve per tu organizuar ne sindikate. Pavaresisht ketyre takimeve midis paleve Kryetari i SPPTSH-se i shprehu shqetesimin e tij z. Gopalan se akoma ka tendencia per mos lejimin e organizimit te lirshem te punonjësve dhe se dialogu social nuk eshte ne piken ku ne si pale do te deshironim te ishte.

Z. Mucaj i kerkoi z. Gopalan qe me autoritetin e tij te nderhyj, jo per favorizime por per nxitje te metejshme te menaxhimit ne Tirane per zhvillimin e nje dialogu social te sinqerte, per ruajtjen e neutralitetit dhe mos pengimit te aktivitetave te sindikates, te cilat kane si qellim informimin e punonjësve dha per nxitje te metejshme te menaxhimit ne Tirane per zhvillimin e nje dialogu social te sinqerte, per ruajtjen e neutralitetit dhe mos pengimit te aktivitetave te sindikates, te cilat kane si qellim informimin e punonjësve.Në vazhdim duhet te jene vet punonjësi, te cilat do te deshironim le ishë: dha per nxitje te metejshme te menaxhimit ne Tirane per zhvillimin e nje dialogu social te sinqerte, per ruajtjen e neutralitetit dhe mos pengimit te aktivitetave te sindikates, te cilat kane si qellim informimin e punonjësve.Në duan apo jo që ti bashkohen sindikates, z. Mucaj gjithashtu e njoju z. Gopalan edhe me iniciativen qe SPPTSH ka nderrmarr per organizimin e një konference mbi sektorin e telekomunikacionit me operatorët Albtelecom, Telekom Albania, Vodafone Albania dhe operator te tjere kombetar ku do diskutohet per sfidat dhe ndryshimet qe priten ta prekin kete sektor si ne zhvillimet teknologjike ashtu që vendet e punës. Ne perfundim te takimit z. Gopalan dhe Drejtoresha e Burimeve njerezore per Europen znj. Eva Somorjai rane dakort qe te komunikojne serish me menaxhimin ne Tirane te Telekom Albania, per te nxitur dialogun social qe edhe pse ka pasur disa zhvillime nuk ka arritur akoma rezultatet ne nivelin e duhur. Znj. Somorjai gjithashtu cilesoi konferencen e sektorit si nje moment shume te mire, te cilin drejtuesit e Telekom Albania mund ta shfrytezojne per zhvillimin e metejshem te dialogut social midis paleve.

REVISTA VJETORE E AKTIVITETIT TE SPPTSH'S

Takim midis SPPTSH dhe Deputeteve ne Parlamentin Gjerman

Në vijim të vizitës me qellim lobimin dhe ndergjegjesimin e te gjitha paleve per veshtiresite qe Sindikata jone ka hasur ne perpjekje per zhvillimin e nje dialogu social te shendetshem për organizimin e sindikatës në Telekom Albania, jane zhvilluar disa takime me *Deputet te Partive te ndryshme te Parlamentit Gjerman, si Partia Social Demokrate e Gjermanise (SPD), Partia Dei Linke, (E majta) Partia Die Grünen(Te gjelberit).*

Takimi i pare u zhvillua ne zyrat Bundestagut me **Deputeten e Partise Social-Demokrate znj. Leni Breymaier.** Mbasi u njoh me te gjithe aktivitetin e sindikates sone dhe veshtiresite qe kemi hasur me degen Deutsche Telekom ne Shqiperi, znj. Breymaier premtoj se do te mbeshteste nismen e Sindikates per te organizuar sektorin e telekomunikacionit dhe do te sensibilizonte te gjithe koleget e asaj ne Parti per ate qe po ndodh ne degen e Deutsche Telekom ne Shqiperi. Znj. Leni Breymaier shperndahu ne faqen e saj zyrtare ne Facebook edhe foton nga takimi i zhvilluar me perfaquesuesit e SPPTSH-se.

Deputeti i Partise se Majte z.Pascal Meiser ne takimin me SPPTSH-ne u shpreh se eshte e pa pranueshme qe kompania Deutsche Telekom te ec me dy standarte , ajo duhet te unfikohet sipas vlerave te T-mobile Gjerman. Z. Meiser premtoi se do te prek opinionin publik e politik ne seancat plenare pasi 1/3 e aksioneve eshte shteterore dhe nuk mund te lejohet qe kompani gjermane te kene standarte dhe parime te tilla. Nese do te jete e nevojshme z. Meiser premtoj te therrase nje interpelance per kete ceshtje. Ai gjithashtu pasqyroj kete problem edhe ne faqen e tij zyrtare ne facebook.



Deputetja e partise se Gjelber, Znj. Beate Muller-Gemmeke ne takim me SPPTSH, tha qe nuk eshte shume e suprizuar pasi eshte perfshire me perpara ne problemet qe Deutsche Telekom ka ne Amerike ku ka udhetuar ne SHBA per te mbeshtetur Sindikaten atje. Ajo u shpreh e gatshme te ngreh zerin edhe per problemet ne Shqiperi si brenda partise se saj por edhe ne parlamentin gjerman. Ajo tha se pervec interpelances me Ministrin perkates do ti drejtonte nje leter autoriteteve shqiptare dhe kompanise mbi problematikat per zhvillimin e dialogut social.

Ndersa ne zyrat e SPD-se perfaquesuesit e sindikates u priten nga **z. Jan Brahmst,**

Referent per Sindikatat dhe Marredheniet e Punes. Mbasi u njoh me situaten z. Brahmst beri nje pershkrim te situates ne Gjermani dhe te partise SPD-se mbi marredheniet qe ata kane me sindikatat, duke qene se Partia SPD ne thelb eshte nje parti qe perfaqeson punetoret. Ai u shpreh i gatshem per te ndikuar dhe ne politiken Shqiptare duke i percjell keto informacione prane departamentit te marredhenieve me jashte.

Nje takim i perzemert u zhvillua me **z.Martin Guttler, Perfaquesuesin e Fondacionit Gjerman Friedrich Ebert Stiftung** ne Berlin, te cilin e falenderuam per bashkepunimin qe fondacioni ka pasur me Sindikaten tone. Z. Guttler u shpreh se eshte i kenaqur qe shikon nje sindikat aktive dhe se i uron fat per te tjera suksese ne te ardhmen SPPTSH.

Takime te tjera me rendesi ne kuader te vizites lobuese u zhvilluan edhe me **Konfederaten Gjermane DGB** ku u ndalem kryesish te menyra e funksionimit te kesaj Konfederate por edhe te situata ne Shqiperi e kryesish te funksionimi i Sindikatave dhe Konfederatave. Me pas u zhvilluan takime te

ndryshmene zyrat e **Sindikates Gjermane Ver.di**

me Perfaquesues te Keshillave te Punetoreve, me

Departamentin e Medias, me Departamentin e

Punes se Mire, me Departamentin e Rinise dhe

me **Kryetarin e Sindikates se Telekomunikacionit** z. Lothar Schroder. Me pas takimet kane

vazhduar me grupin e punes kryesuar nga

Z. Ado Wilhelm ku eshte folur gjate dhe

eshte rene dakord per adoptimin e nje plani te ri

veprimi per organizimin e sindikates ne Telekom Albania.

Takimi eshte mbyllur me diskutimin mbi

Konferencen e Telekomunikacionit qe do te zhvillohet *ne*

Tetor dhe mbi *partneritetin* me **Sindikaten Gjermane Ver.di.**

Me siper kemi ndare me ju disa foto nga keto takime.



KONTRATAT KOLEKTIVE

Kontrata kolektive nuk është vetëm forma ligjore që nënshkruhet midis punëdhënësit dhe sindikatës por është dhe guri kilometrik për zhvillimin e mëtejshëm të dialogut social midis palëve në këtë proces. Viti 2019 ishte një vit shumë i rëndësishëm dhe i sukseshëm për Sindikatën tonë pasi gjatë këtij viti u firmosën **tre kontrata kolektive**. Një nga qëllimet dhe detyrat kryesore të Sindikatës është mbrojtja e të drejtave të punonjësve dhe mekanizmi më i rëndësishëm ligjor që disponon sindikata është kontrata kolektive e cila është një garanci themelore për të gjithë punonjësit. Me firmosjen e kontratave të reja me kompanitë **Albtelecom, Makhes, dhe BTC (Best Training Consulting)** që operon në fushën e call centerit, SPPTSH jo vetëm ka përbushur një nga detyrat e saj, por ka siguruar standarte më të larta pune për të gjithë anëtarët e saj. Prandaj ky vit ka përfunduar si një vit historik ku për herë të parë në historinë e sindikalizmit shqiptar firmoset një kontratë kolektive në sektorin e call center-ave duke e kthyer edhe këtë vend pune në një vend pune të denjë.

Puna per kontratat kolektive ka filluar qe ne muajin Janar 2019. SPPTSH planifikoi ne mbledhjet e saj dhe strategjine qe do te ndiqej. Ne kete proces u planifikuan te perdoreshin:

TRAJNIME / SEMINARE - per informim dhe rritje kapacitetesh me te gjitha grupet e punonjesve
ANKETIM I PUNONJESVE - per te marr opinionin e te gjitheve qe nuk kishin mundesi prezence
TAKIME - u planifikuan takime si brenda kompanive por dhe takime nje me nje.

Si fillim puna e perfaquesuesve te sindikates nisi me një trajnim me ekspertet Gjerman te sindikates Ver.di te cilet ndane me perfaquesuesit e SPPTSH eksperiençen e tyre te procesit te negociatave qe ndodh ne Gjermani gjate firmosjes se kontrates kolektive.

Me pas sindikata ka filluar me anketimin e punonjesve ne kompanine Albtelecom dhe takime brenda kompanise me departamentet perkatese. Pastaj ka vazhduar puna me Seminare me punonjesit e Albtelecom dhe Makhes te cilat jane zhvilluar ne bashkepunim me Fondacionin Gjerman FES dhe Fondacionin Suedez OPC ne Korce, Fier, Tirane,(FES) Gjirokaster, Shkoder, Durres, Tirane. (OPC). Paralelisht ka vazhduar edhe puna per organizimin e punonjesve ne call center-in Best Training & Consulting. Ne perfundim sindikata eshte njojur me te gjitha shqetesimet dhe problematikat e tyre te cilat jane analizuar nga perfaquesuesit e sindikates duke pergatitur edhe një dokument perkates qe do te

**Janë firmosur
3 Kontrata
Kolektive gjatë
vitit 2019**

ALBTELECOM --> 2019 - 2023

MAKHES --> 2019 - 2022

UNIT CENTER --> 2019 - 2022

NEGOCIATA DHE NENSHKRIMI
Negociatat kane zgjatur 4 muaj – Albtelecom
Negociatat kane zgjatur 1 muaj – Makhes
Procesi & Negociatat kane zgjatur 5 muaj – UNIT Center

SPPTSH - FES

SEMINARE KONTRATA KOLEKTIVE

Sindikata e Punonjesve te Poste-Telekomit Shqiptar ne bashkepunim me **Fondacionin Gjerman Friedrich Ebert Stiftung**, nisi serine e pare te seminareve me teme “*Kontrata Kolektive ne sektorin e Telekomunikacionit*”. Në këto takime morën pjese punonjes te kompanive ALBtelecom dhe Makhes se Rajoneve: *Elbasan, Korce, Berat, Fier, Vlore dhe Tirane*.

Gjatë takimeve punonjesit paten mundësi të informohen më shumë mbi marrëdhëniet e punës dhe kontratën kolektive. Gjithashtu diskutuan me perfaqesuesit e sindikates mbi kerkesat dhe problematikat e tyre te cilat deshirojne ti permiresojne me ane te negociatave te sindikates dhe kontrates se re kolektive.

1- Trajnim ne Korce – Kontrata kolektive ne sektorin e Telekomunikacionit (2 Shkurt 2019)



2- Trajnim ne Fier – Kontrata kolektive ne sektorin e Telekomunikacionit (9 Shkurt 2019)



3- Trajnim ne Tirane – Kontrata kolektive ne sektorin e Telekomunikacionit (16 Shkurt 2019)



SPPTSH - OPC

SEMINARE KONTRATA KOLEKTIVE

Sindikata e Punonjesve te Poste-Telekomit Shqiptar ne bashkepunim me **Fondacionin Suedez Olof Palme Center**, zhvilloi serine e dyte te seminareve me teme “*Kontrata Kolektive ne sektorin e Telekomunikacionit*”. Në këto takime morën pjese punonjes te kompanive ALBtelecom dhe Makhes se Rajoneve: *Shkoder, Lezhe, Gjirokaster, Sarande, Tepelene, Durrës, Kavaje, Kruje dhe Tirane*. Gjatë takimeve punonjesit paten mundësi të informohen më shumë mbi marrëdhëniet e punës dhe kontratën kolektive. Gjithashtu diskutuan me perfaqesuesit e sindikates mbi kerkesat dhe problematikat e tyre te cilat deshirojne ti permiresojne me ane te negociatave te sindikates dhe kontrates se re kolektive.

**1- Trajnim ne Shkoder –
Kontrata kolektive ne sektorin e
Telekomunikacionit (8 Qershor 2019)**



**2- Trajnim ne Gjirokaster –
Kontrata kolektive ne sektorin e
Telekomunikacionit (22 Qershor 2019)**



**3- Trajnim ne Durrës –
Kontrata kolektive ne sektorin e
Telekomunikacionit (21 Shtator 2019)**



**1- Trajnim ne Tirane –
Kontrata kolektive ne sektorin e
Telekomunikacionit (28 Shtator 2019)**





KONTRATA KOLEKTIVE NE “MAKHES ALBANIA”

Sindikata e Punonjesve te Poste-Telekomit Shqiptar pas negociatave me punedhenesin **MAKHES ALBANIA** ka arritur firmosjen e kontrates kolektive.

Gjate ketyre negociatave Sindikata eshte fokusuar per zgjidhjen e problematikave dhe kerkesave, te cilat jane identifikuar gjate takimeve me punonjesit e kompanise. Mbas analizimit te tyre eshte mbajtur ne fokus sidomos pjesa e te punuarit me ore te zgjatura, mos pagesa e oreve jashte orarit, shqetesimet per mos informimin mbi pagen dhe oret shtese te paguara, siguria dhe shendetit ne vendin e punes, indeksimi i pagave, mungesa e bazes materiale etj.

Te gjitha keto shqetesime jane reflektuar ne kontraten e re te punes firmosur me Makhes Albania.

Te gjithe punonjesit jane informuar nga sindikata mbi i te drejtat kryesore qe lindin nga kjo Kontrate Kolektive.



KONTRATA KOLEKTIVE NE

“ALBTELECOM”



Sindikata e Punonjesve te Poste-Telekomit Shqiptar, pas 4 muaj negociatash me punedhenesin Albtelecom, ka arritur firmosjen e kontrates kolektive. Gjate ketyre negociatave Sindikata eshte fokusuar per zgjidhjen e problematikave dhe keresave te cilat jane identifikuar gjate anketimit dhe takimeve me punonjesit e kompanise. Dy nga ceshtjet kryesore te cilat kane mbajtur “peng” negociatat per nje periudhe te gjate kohore kane qene:

Indeksimi i pagave dhe Bonusi i Vtitit te Ri.

- **Indeksimi i pagave (Inflacioni)** ishte pika kryesore qe u diskutua gjate negociatave. Sindikata mbi argumentat e saj te parashtruara per situaten e permiresuar financiare te kompanise kerkoi rritjen e pagave per te gjithe punonjesit. Gjithashtu ju be e qarte kompanise se punonjesit kane ankesa rreth pages qe ska ndryshuar nder vite dhe kjo kerkese duhet te permbushet ne kontraten e re kolektive, pasi ka 4 vjet qe pagat nuk ndryshojne dhe aplikimi i rritjes se pagave do te sherbente per motivimin e ty-re. Kompania deklaroit se situata aktuale ka permiresim por perseri vazhdon me humbje duke pasur shume deficite dhe pak likuiditet. Pamundesa e rritjes se pagave duke marre parasysh normen e inflacionit justifikohet nga kompania me faktin qe punonjesve ju jepet shperblimi i performances dhe kjo performance kap nje vlere prej 4 fish me te larte sesa vlera e inflacionit. Kompania ka si strategji te stimuloje punonjesit qe performojne me mire. Sindikata ka theksuar perseri se gjendja e kompanise eshte permiresuar prandaj kerkon aplikimin e inflacionit pasi vlera per rritjen e pagave eshte nje per-qindje e vogel krahasuar me rikuperimin e humbjes qe ka bere kompania. Sindikata ka deklaruar se mabetet e interesuar ne aplikimin e nje drejtesie sociale per te gjithe, prandaj kerkon rritje pagash per te gjithe punonjesit. Mbas negociatave te vazhdueshme, duke marre parasysh edhe pritshmerite e kompanise per permiresimin e gjendjes aktuale ne vitin 2020, u ra dakord qe indeksimi i pagave te filloj nga viti i ardhshem per te gjithe punonjesit.

Gjithashtu kompania do te mbaje ne vemendje personelin e konsideruar kyc, duke bere edhe permiresime te metejshme pagash per kete kategori.



- **Bonusi i Vitit te Ri** per te cilin sindikata kerkoi qe ky bonus te jetë nga 20,000 Leke deri ne 30,000 Leke ne varesi te gjendjes financiare te kompanise ne fund te vitit. Duke marre per baze situaten aktuale financiare, kompania kerkoi mos perfshirjen ne kontraten e re te bonusit te vitit te ri. Sipas politikeve te kompanise nuk mund te jepen dy bonuse per punonjesit duke qene se do vazhdoj te jepet bonusi i performances. Sindikata nuk e pranoi kete qendrim dhe deklaroi se nje gje e tille demotivon punonjesit dhe se gjithashtu duhet te punohet per te rritur standartet per punonjesit, pasi vetem me punonjes te kenaqur, mund te kemi rezultatet e deshiruara dhe te jemi te paret. Qellimi jone eshte te bejme hapa perpara dhe jo mbrapa.Kompania kembenguli ne pamundesite financiare dhe qendrimin e saj kunder dhenies se nje bonusi qe nuk bazohet ne performance.Sindikata refuzoi heqjen nga kontrata te kesaj pike. Gjate kesaj periudhe ne tavolinen e diskutimeve u hodhen alternativa te tjera. Kompania hodhi idene e dhenies se kuponave per blerje ushqimesh ne vend te bonusit (por pa percaktauar shumen). Sindikata e refuzoi kete propozim pasi kjo kushtezon punonjesit per te shpenzuar leket ne supermarket per ushqime.



Sindikata insistoi qe kompania nuk duhet te preke shperblimin pasi kjo eshte nje e drejte e punonjesve e fituar nder vite, dhe i propozoi kompanise nese nuk ka mundesi financiare bonusi te jepet si rritje page per te gjithe punonjesit, rreth 3% e pages, e njejtë shume te merret e shtrire ne kohe gjate gjithe vitit por ky propozim u refuzua.Duke qene se palet ishin te ndara ne qendrimet e tyre, u afrua nje qasje tjeter e kesaj ceshje. Marr shkas nga arsyet kryesore te cilat jane financiare, cdo gje varejnga te ardhurat deri ne fund te vitit, u pyet kompania nese ishte deshira per ta shperndare kete bonus. Kompania u per gjigj pozitivisht qe ekzistonte deshira e shperndarjes se bonusit. Atehere sindikata kerkoi qe kjo pike te mbetet ne kontrate dhe ne fund te vitit te shikohej perseri situata aktuale financiare. Duke qene se ekziston deshira per ta dhene kete bonus, atehere ky bonus t'ju shperndahet punonjesve. Kjo qasje e re e paleve per kete ceshje beri te mundur zgjidhjen e ketij ngerci te krijuar gjate negociatave, ku u vendos qe kjo pike te mbetet ne kontrate.



SPPTSH - HAP HISTORIK NE ORGANIZIMIN E SEKTORIT CALL CENTER



Sindikata e Punonjesve te Poste-Telekomit Shqiptar qe prej dy vjetesh ka nisur punen per te organizuar sektorin e call center-ave duke filluar me trajnime dhe ngritjen e kapaciteteve per keta punonjes. Në bashkëpunim me Albanian Business Services Association dhe me fondacionin Friedrich Ebert organizoi trajnimin "Përfaqësimi i interesave të punëmarrësve në kompanitë Call Center". Ky trajnim kishte si qëllim informimin e punonjësve të kësaj industrie mbi mundësitë e përmirësimit të marrëdhënieve të punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit. Gjithashtu u hodhën propozimet për krijimin e sindikatës së Call Center-ave.

Keto perpjekje u rriten akoma me shume gjate bashkepunimit me organizaten "Together for Life" dhe me mbeshtetjen e Fondacionin Suedez Olof Palme Center. Te dyja organizatat filluan trajnimet me një grup përfaqësuesish të punëmarrësve në sektorin e Call Center, grup i krijuar për organizimin sindikal në sektorin Call Center. Ata janë informuar përmes trajnimeve dhe diskutimeve të shumta mbi të drejtat e tyre në punë. Mbas trajnimeve filloi dhe organizimi i punonjesve ne një prej kompanive te sektorit call center UNIT CENTER (Best Training Consulting.)

Me pas filloi puna per anetaresimin e punonjesve ne sindikate. Ne kuader te ngritjes se strukturave sindikale, u zhvillua takimi i radhes per zgjedhjen e perfaqesuesve te sindikates ne call centerin UNIT CENTER, qe eshte call centeri i pare ne Shqiperi me perfaqesim sindikal. Anetaret e sindikates zgjodhen perfaqesuesit e seksionit te tyre qe do te jene dhe pjese e keshillit kombtar te SPPTSH-se. Mbas organizimit te strukturave sindikata filloi punen per lidhjen e kontrates kolektive.





KONTRATA KOLEKTIVE NE “UNIT CENTER”

Sindikata e Punonjësve të Postë Telekomit Shqiptar mbas një pune të gjatë dy vjecare ka arritur të firmos në muajin Nëntor 2019, kontratën e parë kolektive në sektorin e call centerave, duke vendosur kështu gurin e parë kilometrik në punën e gjatë të organizimit të punonjësve të këtij sektori. Kontrata kolektive e punës e firmosur ndërmjet Sindikatës së Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar dhe punëdhënësit “Best Training & Consulting” siguron standarte më të larta dhe mbrojtje për të 200 punonjësit e kësaj kompanie. Gjatë firmosjes së kontratës, Administratorja e Shoqërisë znj. Ersenilda Elezi u shpreh e kënaqur për faktin që janë kompania e parë në Shqipëri në fushën e call centerave që firmosin kontratë kolektive.

“Fokus i jonë ka qenë gjithmonë rritja e standardeve dhe kushteve të punës, pasi vetëm duke pasur punonjës të kënaqur mund të ofrojmë shërbime akoma më të mira për klientët tanë, urojmë që kjo kontratë të shërbej si një udhërrëfyes, për rrugën që duhet të ndjekin edhe kompanitë e tjera të ketij sektori.” – tha znj. Elezi. Ndërsa per kryetarin e sindikatës z. Renato Mucaj, ky është një moment historik pasi nuk garanton vetëm të drejtat e këtyre punonjësve, por e ngre marrëdhënien punëdhënës-punëmarrës në një standart tjetër duke u bërë kështu një shembull dhe për kompanitë e tjera. Z. Mucaj, falenderoi punonjësit, organizatën “Together For Life” dhe të gjithë ata që kontribuan në këtë periudhë 2 vjecare organizimi. Kontrata Kolektive është e vlefshme për të gjithë punonjësit e Shoqërisë “Best Training & Consulting” duke i siguruar punëmarrësve të drejtën të mbrohen nga kjo kontrate. Gjithashtu kontrata kolektive përcakton qartë dhe garanton mbrojtjen nga diskriminimi, trajtimin e barabartë të punëmarrësve, mbrojtje të vecantë për gratë shtatëzanë, mbrojtjen e të dhënave personale, pushimet vjetore, pushime të tjera për raste të vecanta, pagesat e orëve jashtë orarit dhe gjatë ditëve të festave, rishikimi i pagave, shpërblimet, sigurinë dhe shëndetin në punë, vlerësimin e performancës, shpërblimet mbi vjetërsinë në punë, liritë sindikale dhe të drejtën e grevës. Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar do të monitoroj dhe njëkohësisht do të vazhdoj punën për organizimin e mëtejshëm të punonjësve në kete sektor.

KESHILLI KOMBETAR I SPPTSH



Ne mbeshtetje te neneve 19 dhe 20 te Statutit te Sindikates se Punonjesve te Poste-Telekomit Shqiptar jane zhvilluar rregullisht mbledhjet e keshillit sic parashikohet ne statutin e SPPTSH-se. Ne mbledhjen permbyllese te dates **14 Dhjetor 2019** zhvilluar ne mjediset e hotel "Doro City" e drejtar nga Kryetari i Sindikates z. Renato Mucaj ku u be prezantimi dhe analiza e te gjithe aktivitetave te zhvilluara gjate vitit 2019.

Sekretarja Organizative znj. Irida Marku pas verifikimit te liste-prezences, konstatoi se pjesemarrja ishte e mjaftueshme per te zhvilluar mbledhjen. Ne fjalen e hapjes kryetari theksoi se eshte nevoje paresore per nje perfaqesim sa me dinjitoz qe cdo anetar i keshillit te kete njohje te plote te statutit te sindikates, kontratave dhe te gjitha te drejtave qe rrjedhin nga keto kontrata. Cdo perfaqesues duhet te angazhohet ne fushatat e



anetaresimeve per te thithur ne sindikate te rindje ardhur rishtazi ne pune. Mbledhja vazhdoi me rendin te dites. Mbas raportimit dhe analizes se aktivitetit sindikal gjate vitit 2019, u rishiku edhe njehere disa pika te dokumentit te strategjise se sindikates 2017-2022. Kryetari kerkoi edhe njehere angazhimin e te gjitheve per realizimin e objektivave te vendosur ne dokumentin e strategjise.

RENDI I DITES

Informacion i per gjithshem per aktivitetin e Sindikates mbi 6 Majoren e I&II te 2019

Diskutim mbi dokumentin e strategjise se Sindikates

Miratimi i ndryshimeve te organizimit te brendshem te Sindikates

Raporti i Anetaresimeve, Raporti Financiar dhe Projekt Buxheti

Plani i aktivitetave per vitin 2020


Diskutim i lire mbi problematika te tjera



Theksi u vu mbi rritjen e antaresimeve, perfaqesimin dinjitoz ne cdo seksion dhe rajon, si dhe monitorimin e kontrates kolektive, ku per kete do te kete dhe nje trajnim te posacem per te gjithe anetaret e keshillit kombetar. Pas miratimit te ndryshimeve ne planin e strategjise, u diskutua organizimi i brendshem i sindikates duke shtuar ne strukturat e sindikates edhe pjesen e call center. Ne kete mbledhje u miratuan dhe perfaqesuesit e rinj te keshillit kombetar te cilet kane kaluar nga nje trajnim i mirefillt zhvilluar me partneret tane te konfederates amerikane. Mbledhja vazhdoi me pas me miratimin e raporteve te anetaresise, raporteve financiare dhe projekt buxhetin per vitin e ardhshem hartuar mbi planin e aktiviteve per vitin 2020. Ne vazhdim u diskutua per projektin **"Nje sindikate per te gjithe"** dhe mbi problematika te tjera te cdo seksioni dhe rajoni te sindikates.

Ne kuader te rritjes se transparences per anetaret, Keshilli Kombetar vendosi qe te publikoj ne perqindje (%) shperndarjen e shpenzimeve per vitin 2019.

Shperndarja e shpenzimeve ne % per vitin 2019



A JE GATI PER NJE EKSPERIENCE NDRYSHE ?

SINDIKATA E POSTE-TELEKOMIT SHQIPTAR NE BASHKEPUNIM ME QENDREN E SOLIDARITETIT TE KONFEDERATES AMERIKANE, OFRON KETE TRAJNIM PER TE GJITHE TE INTERESUARIT NE CESHTJET E ORGANIZIMIT, KOMUNIKIMIT DHE PERFAQESIMIT TE PUNONJESVE.


3 FUNDJAVA 3 TRAJNIME

APLIKO TANI!

AFATI I FUNDIT: 31 MARS 2019



TRAJNIMI I RE FILLON NE DT. 13-14 PRILL 2019



SEMINAR “ORGANIZIMI I PUNONJESVE” SPPTSH - “FSP - PTK”-SPTSH - AFL - CIO

Sindikata e Punonjesve te Poste-Telekomit Shqiptar, ne kuader te trajnimit te punonjesve qe duan te jene perfaquesues punetoresh ka organizuar tre trajnime ne bashkepunim me Qendren e Solidaritetit te Konfederates Amerikane AFL-CIO. Nje trajnim eshte zhvilluar mbi organizimin e fushatave ku pervec sindikates sone ka qene e ftuar dhe Federata Sindicale e Pavarur e Poste Telekomit te Kosoves. Ky trajnim 2- ditor ishte nje mundesi shume e mire per te dyja sindikatat qe te ndanin eksperiencat e tyre dhe te mesonin me shume per aplikimin e metodologjive efikase ne veprimtarite sindikale. Dy trajnimet e tjera me qendren e solidaritetit te konfederates amerikane AFL-CIO, jane zhvilluar per koordinimin dhe organizimin e perfaqesimit te punonjesve ne datat *13-14 Prill dhe ne 18-19 Maj 2019*. Ne kete trajnim moren pjese anetare te sindikates sone dhe te sindikates se tipografise. Lektori **z. Laurie Clements**, (drejtori rajonal i qendres se solidaritetit) solli shembuj te shumte nga eksperiencia e tij shume vjecare me sindikatat duke e kthyer ne nje eksperience te shkelqyer per te gjithe pjesemarresit.



SHITJA E TELEKOM ALBANIA – PO PUNONJESIT?

Sindikata e Punonjesve të Poste-Telekomit Shqiptar u informua per shitjen nga kompania greke OTE, pjesë e grupit Deutsche Telekom, te aksioneve ne kompanine Telekom Albania tek kompania bullgare “Albania Telecom Invest AD”. Duke patur deri tani kontrollin e aksioneve, kompania OTE e ka menaxhuar kompaninë shqiptare Telekom Albania, e cila puneson 27 perqind te punonjesve ne sektorin e komunikimeve celulare ne Shqiperi.

Duke pare nje sektor komunikimeve celulare ne Shqiperi, si kudo perreth nesh dhe ne bote, ne ndryshim radikal dhe te vazhdueshem, veprimtaret e te cilit ndodhen perpara ndryshimeve vendimtare dhe nën presion të lartë, si dhe, sipas komunikimit zyrtar te kompanise OTE, kohen brenda gjysmës së parë të vitit 2019 qe shitja e Telekom Albania te përfundojë, pas lejes dhe miratimit nga autoritetet kompetente shqiptare, Sindikata e Punonjesve të Poste-Telekom Shqiperi u kerkon autoriteteteve si me poshte:

1. Ministrise se Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencise dhe ne veçanti Autoritetit te Komunikimeve Elektronike dhe Postare(AKEP), i cili është organi rregulator në fushën e komunikimeve elektronike, qe te bejne publike negociatat dhe te sigurojne se plani i biznesit i kompanise bullgare “Albania Telecom Invest AD” do te ruaje vendet e punes aktuale ne kompanine Telekom Albania dhe nuk do te aplikoje shkurttime drastike te vendeve te punes, me justifikim futjen e teknologjive te reja.

2.Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin te Kuvendit te Shqiperise qe te mbikqyre me kujdes dhe rreptesisht keto negociata, per te mos lejuar cenimin e interesit publik, ne rradhe te pare te se ardhshmes se vendeve te punes ne kompanine Telekom Albania, si dhe te kerkonte pranimin nga kompania investuese “Albania Telecom Invest AD” realizimin e kontrates kolektive te punes me punonjesit e Telekom Albania, si një garanci me shume per sigurimin e vendeve te punes.

Sindikata e Punonjesve të Poste-Telekom Shqiptar do te ndjeke kete proces nga afera do te kunderve-proje, ne rast te konstatimit te shkeljeve ndaj legjislacionit ekzistues shqiptar per te drejtat e punemarrësve.

Declarata per Shtyp ka gjetur pasqyrim ne shume media te shkruara dhe ne dy televizone ScanTV dhe Ora News.

SCAN TV
ORA NEWS
GAZETA SHEKULLI
GAZETA STANDART
GAZETA TELEGRAF
A2NEWS
GAZETASI.AL
EKONOMIX.AL
BIZNESMAG
NEWSBOMB

Shitja e Telekom, punonjësit duan garanci për punën

Shitja e Telekom Albania, punonjësit kërkojnë garanci



KESHILLAT E PUNETOREVE - SI FUNKSIONOJNE NE GJERMANI? A MUND TE APLIKOHET I NJEJTI SISTEM NE SHQIPERI ?

Nën kujdesin e FES Tirana ne kuader te forcimit te perfaqesimit te punetoreve eshte ndermarr një **vizite studimore ne Gjermani**, ku **sindikata gjermane Ver.di** mori persiper zhvillimin e kesaj vizite. Grupi i punes qe perbehej nga z. *Genci Lamllari - FES Tirana*, z. *Renato Muçaj - Kryetar i SPPTSH-se*, znj. *Plejada Gugashi - OPC Tirana*, znj. *Eni Mjeshtri - CLR*, z. *Ledio Milkani - Ekspert ligjor* dhe z. *Fatos Cocoli - Gazetar & Ekspert ekonomie*. Gjate vizites studimore grupi i punes pati mundesi te njihej nga afer si ne aspektin teorik dhe ne aspektin praktik duke marr pjese dhe ne një mbledhje te keshillit te punetoreve te Deutsche Telekom. Ky studim i nisur do te pasohet ne Tirane me një tavoline te gjere diskutimi.

Nën kujdesin e **FES Tirana dhe Olof Palme International Center**, përfaqësues të organizatave punëtore në Gjermani kanë ndarë eksperiencat e tyre për organizimin punëtor në vendin e tyre. Këshillat e punëtorëve dhe dialogu social kanë qenë tema kryesore që ka mbledhur në një tryezë të përbashkët diskutimi aktivistë, përfaqësues te shoqërisë civile dhe sindikatave. Ky takim ka sjellë në vëmendje diskutime që lidhen me sindikatat dhe rolin e tyre në Shqipëri, ku pjesëmarrësit kanë ndarë njëzëri mendimin se sindikatat e vjetra janë pothuajse inekzistente dhe lind nevoja për një riorganizim të tyre ose krijimin e sindikatave të reja.

Për **Renato Muçaj, kryetar i SPPTSH-se**, sindikatat aktuale kanë nevojë për reformim dhe në punën e tyre mbështetja nga ana e shoqërisë civile është mjaft e rëndësishme. *"Ato sindikata që nuk janë të hapura drejt reformimit nuk mund të quhen më sindikata. Nuk i bashkohem mendimit që në cdo kompani duhet të ketë sindikata, sepse nëse i referohemi shembullit të VERDI, është bashkimi i 5 sindikatave dhe prandaj është bërë kaq sindikatë e fuqishme, sepse u bashkuan. Duhet të kemi më shumë sindikata të profilizuara në sektor. Sindikatat duhet të ngrenë zërin që të mos bëhet një ligj dhe pastaj të përfundojë sic përfundojnë të gjitha ligjet shqiptare"*.

Këshillat e punëtorëve, term i ri ky për realitetin shqiptar, por mjaft i rëndësishëm për rolin e tyre në Gjermani kaloi me diskutime nga të pranishmit, për vetë eksperiencën e mëparshme nga roli që kanë pasur sindikatat.



PUNONJESIT E CALL CENTER-AVE TE STRESUAR DHE PA PERFAQESIM SINDIKAL

Call center-at në Shqipëri janë një nga sektorët me numrin më të madh punonjësve. Një analizë krahasuese mbi të drejtat e punës, legjislacionin, rregulloret dhe politikat në sektorin call center, e hartuar nga shoqata "Together for life" dhe Sindikata e Punonjesve te Poste Telekomit Shqiptar nxjerr në pah disa nga problematikat me të cilat përballen punonjësit. Sipas analizës, kjo kategori punonjësish, pjesa më e madhe e të cilëve janë në moshë të re, përballen me probleme shëndetësore, si stresi, probleme të shtyllës kurriore, problemet me veshët, shoku akustik etj.

Një tjetër element që ka nxjerrë në pah analiza është përfaqësia sindikale, e cila pavarësisht përpjekjeve nuk ia ka dalë të formalizohet dhe të mbrojë të drejtat e të punësuarve. Kjo sepse një pjesë e të punësuarve të këtij sektori e shohin atë si një punë provizore, por edhe për shkak të ndëshkimeve indirekte në rastet e ngritjes së zërit. Në kushte të tillë, nevoja për një organizim sindikal është imediate. Kontratat kolektive janë hapi i parë në këtë drejtim.

Aktualisht në Shqipëri, ky sektor ka rrëth 25 mijë të punësuar dhe përbën 5% të PBB-së. Rreth 79,5 % e punonjësve të këtyre bizneseve i përkasin grupmoshës 18-30 vjeç. 69,2% e tyre janë femra, ndërsa 30,8 % janë meshkuj.



TAKIME NGA AKTIVITETI SINDIKAL I SPPTSH GJATE VITIT 2019 SPPTSH NE KOMISIONIN PARLAMENTAR TE BARAZISE GJINORE

SPPTSH NE KOMISIONIN PARLAMENTAR TE BARAZISE GJINORE



12 Shkurt 2019 - SPPTSH mori pjesë ne komisionin parlamentar te barazise gjinore, ku u zhvillua degjese me deputet e komisionit, per zbatimin e Ligjit te Sigurise dhe Shendetit ne pune, ku nder te tjera kryetari i sindikates z. Renato Mucaj, propozoi ngritjen keshillave te sigurise dhe shendetit ne pune, forcimin e rolit te anetarit te ketyre keshillave duke nderhyre ne ligj per tu dhene nje status mbrojtje gjate ushtrimit te funksioneve te tyre dhe nxitjen e hartimit te dokumentit te vleresimit te riskut.

SPPTSH NE FORUMIN “Sindikatat shqiptare te gatshme per BE-ne”

26 Mars 2019 - Fondacioni Gjerman Friedrich Ebert zhvilloj forumin diskusional me teme “Sindikatat shqiptare te gatshme per BE-ne”. Ne kete forum u prezantuan gjetjet e studimit mbi perceptimin e publikut dhe te sindikalisteve mbi performancen e sindikatave ne Shqiperi. Ne kete studim u perfshire edhe anetare te SPPTSH-se te cilet dhane mendimet e tyre per performancen e sindikates. Ne kete forum ishte i pranishem z. Peter Seideneck, Keshilltar prane Konfederates Europiane te Sindikatave (ETUC), i cili foli per situaten e sindikatave ne Europe dhe sfidat e sindikatave Shqiptare drejt BE-se. Ne kete forum kryetari i sindikates Z. Renato Mucaj, hodhi idene e nje bashkepunimi gjitheperfshires per te organizuar tubimin e 1 Majit, ku ju kerkoj te gjithe aktoreve kryesore te sindikatave, konfederatave dhe shoqerise civile te bashkoheshin per kete tubim per ti percuar kerkesat e punonjesve qeverise shqiptare.



TAKIM ME PERFAQESUESIT E KONFEDERATES AMERIKANE AFL-CIO

3 Prill 2019 – Perfaquesues te SPPTSH-së ne takim me perfaquesuesit e konfederates Amerikane AFL-CIO per te diskutuar mbi bashkepunimin dhe programin e trajnimit qe do te zhvillohet ne dt. 13-14 Prill 2019 ne Tirane me Sindikaten e Punonjesve te Poste-Telekomit Shqiptar.



SEMINAR ME PERFAQESUESIT E SINDIKATES GJERMANE VERDI - FES

27 & 28 Prill 2019 - Sindikata zhvilloi nje takim me ekspertet gjerman **Ado Wilhelm, Pascal Röckert** nga Sindikata Gjermane Ver.di, te cilet ne kuader te partneritetit strategjik kane asistuar me eksperienca e tyre fazen perqatitore per nenshkrimin e "Kontrates kolektive". Ne kete takim moren pjese edhe perfaquesues te Sindikates se tipografise. Ky takim dy ditor u mbeshtet nga Fondacioni Friedrich-Ebert, zyra e Tiranes.



SPPTSH DEKLARATË SOLIDARITETI

30 Korrik 2019- SPPTSH u solidarizua me greven e kolegeve te Sindikates se Telekomit te Kosoves për situatën e fundit të krijuar në Telekomin e Kosovës ne kundërshtim të firmosjes se nje kontrate të re me Z-Mobile, pasi deri tani kontrata aktuale 10 vjecare e ka demtuar rrëth 200 milion euro. Kryetari i SPPTSH-se ka zhvilluar nje bisede telefonike me Kryetarin e FSP-PTK, z.Lamih Balaj ku eshte informuar mbi situaten dhe zhvillimin e greves. z. Muçaj ka shprehur te gjithe solidaritetin edhe te gjithe mbeshtetjen logjistike qe mund ti nevojitet sot kolegeve te FSP-PTK duke i siguruar se SPPTSH eshte perkrah tyre ne kete perpjekje per tja rikthyer Telekomin punonjesve dhe per te mos lejuar me kontrata abuzive.



SPPTSH PRONONCIM PER CALL CENTER NE "SCAN TV"

1 Tetor 2019 - Kryetari i Sindikates z. Renato Muçaj, ka zhvilluar nje interviste ne Televizionin SCAN ne emisionin #PERTEFOL, me gazetarin Eri Saraci per te diskutuar mbi problematikat e sektorit te telekomunikacionit, call center, ndryshimet teknologjike, kontratat kolektive dhe organizimin sindikal!



SPPTSH TAKIM ME DEPUTET GJERMAN PER INTEGRIMIN EUROPIAN

10 Totor 2019 - Kryetari i SPPSH ka marre pjese ne takimin organizuuar nga Fondacioni Friedrich Ebert, me dy deputet Gjerman te SPD-se z. Christian Petry dhe z. Metin Hakverdi dhe Ambasadorin Gjerman z. Peter Zingraf, per te diskutuar mbi prespektiven Europiane te Shqiperise, pritshmerite e sindikatave dhe te shoqerise civile. Gjate ketij takimi patem mundesi te diskutonim dhe lobonim per mbeshtetjen qe EU dhe Gjermania duhet ti jap Shqiperise per hapjen e negociatave. I siguruam deputetet se jemi koshiente per rrugen e gjate gjate procesit te integrimit por hapja e negociatave ne kete moment do te ishte nje mbeshtje e madhe per Shqiperine dhe popullin Shqiptare.



SPPTSH TAKIM ME SHEFEN EKZEKUTIVE TE QENDRES SE SOLIDARITETIT

14 Totor 2019 - U zhvillua një takim i rëndësishëm midis përfaqësuesve të SPPTSH-së dhe delegacionit të Qendrës së Solidaritetit të konfederatës amerikane AFL-CIO, i ardhur nga Amerika, kryesuar nga Znj. Shawna Bader-Blau – Drejtore Ekzekutive e Qendrës, Z. Rudy Porter – Drejtor Rajonal, Jeff Wheeler-Koordinator Programesh, Laurie Clements- Drejtor i Programeve për Serbinë, Bosnjën, Malin e Zi dhe Shqipërinë. Gjatë takimit delegacionet diskutuan për progamat e zhvilluara me Qendrën e Solidaritetit dhe për bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet të dy organizatave. Znj. Shawna Bader-Blau vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm dhe përgëzoi Sindikatën për punën e saj në lëvizjen sindikaliste. Gjithashtu Kryetari i Sindikatës Z. Mucaj, u shpreh i kënaqur për ekspertizën që Qendra ka dhënë në trajnimin e përfaqësuesve të sindikatës dhe i kërkoi Qendrës vazhdimin e bashkëpunimit.



SPPTSH NE PANELIN E DISKUTIMIT TE EMISIONIT “ARGUMENT” NE “SCAN TV”



18 Nentor 2019 - Në emisionin “Argument” në Scan Tv ka qene i ftuar kryetari i sindikatës z. Renato Mucaj per të folur mbi tregun e punës, parë nga syri i millenials, sfidat e reja të punëmarrësve, sfidat e brezit të ri, puna në call center, teknologjia etj.

AKTIVITET SOCIAL NE SELANIK PER ANETARET E ALBTELECOM & MAKHES

Sindikata e Punonjësve të Post-Telekomit Shqiptar, në vazhdim të aktiviteteve sociale, per te rritur frymen kolektive te punonjesit ka organizuar *per anetaret e Albtelecom dhe Makhes* një udhetim ne qytetin e bukur te Selanikut. 52 anetare te sindikates kane udhetuar se bashku një fundjave ne qytetin e Selanikut. Per gjate tre diteve te gjithe kane pasur mundesi te shijojne programin e perqatitur nga agjensia dhe te shetisin pjeset me te bukura te Selanikut. Mbështetjeve te shumta dhe pazarave ne dyqanet e qytetit te gjithe kane shijuar një mbremje fantastike ne një prej buzukeve te Selanikut. Udhetimi i reklasoi te gjithe pjesemarresit dhe i afroi me shume me njeri tjetrin. Nuk ka munguar adrenalina e grupit per gjate gjithe rruges duke e kthyer kete ne një udhetim qe do mbahet mend gjate.



Se bashku na presin eksperienca te bukura edhe ne vazhdim!

PERFITIME PER ANETARET E SINDIKATES

Te dashur anetare,

Sindikata jonë në bashkëpunim me bizneset e mëposhtme ka menduar qe edhe kete vit t'u ofroje anetareve te saj mundesine per te perfituar ulje ne disa sherbime. Ne vijim te politikave tona per ta kthyer kete sindikate ne funksion te anetareve, kemi vendosur qe serish cdo anetar i SPPTSH mund te sjelle deri ne 2 te njojur apo familjar te interesuar. Keta te fundit do te perfitojne te njejtat sherbime (familjaret apo te afermit nuk mund te jene punonjes te Albtelecom / Makhes - jo anetare te sindikates). Me poshte ndodhet lista e shembuve dhe perfitimet perkatese:

1. KINEMA “IMPERIAL” - Anetaret i perfitojne biletat vetem me 300 Leke/bilete nga 500 Leke qe eshte vlera normale e biletave). Ata mund te shijojnë filmat me te fundit cdo dite, ne cdo orar dhe ne cdo sallë te Kinema Imperial.

Kjo oferte eshte e vlefshme per gjate gjithe vittit.

2. QENDRA ESTETIKE “GLOW BEAUTY CENTER”
- U ofron anetareve tane meshkuj/femra ulje prej 20-25% mbi sherbimet qe kjo qender ofron.

Paketa te personalizuara per anetaret e sindikates me cmime akoma me te reduktuara.

3. KLINIKA DENTARE “XHOLI” - Ne te dy pikat e saj ofron 20 % ulje ne sherbimet dentare per te gjithe anetaret e sindikates.

4. MAGNET GYM & FIT - Oftron cmime preferenciale dhe paketa te personalizuara per anetaret e Sindikates.


5. PARADISE LUKOVA HOTEL & PRIVATE BEACH
- Ofron paketa pushimesh me cmime preferenciale per anetaret e saj. Vlera e saj eshte 25 Euro/person ku perfshihet:

- * Dhoma e Hotelit
- * Mengjes & Darke
- * Aksesi ne pishinen e Hotelit
- * Transporti Hotel - Plazhi i Lukoves - Hotel
- * Shezlon & Cader



Te gjithe anetaret e interesuar qe duan te perfitojne nga keto sherbime mund te kontaktojne me **Sekretarine Organizative** te Sindikates (Irida Marku) ose me keto nga **Perfaqesuesit e Sindikates** ne sektionet e tyre. Per te lexuar listen e detajuar te ketyre paketave viziton faqen tone te webit www.sindikata.net

Ne te gjitha pikat e sherbimit anetaret dhe familjaret e tyre duhet te paraqiten ne emer te Sindikates se Punonjesve te Poste Telekomit Shqiptar qe te perfitojne uljet e parashikuara.



REVISTA VJETORE E AKTIVITETIT TE SPPTSH`S